



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 10.7.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Liburn Aliu, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Salih Zyba, Enver Hoti.

Munguan: Besa Gaxherri dhe Srđan Mitrović.

Pjesëmarrës të ftuar nga komisioni: Nenad Rikalo-ministër i MBPZHR-së, Mevlydin Krasniqi zëvendësministër, Ekrem Gjokaj u.d. i kryeshefit të AZHB-së, Bekim Hoxha-drejtor i Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë dhe Adem Arifaj-kryetar i komisionit për vlerësimin e dëmeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Editë Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 3.7.2018;
3. Raportimi i ministrit të Bujqësisë për dëmet e fundit në Kosovë nga reshjet e shiut;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.7.2018 dhe 26.6.2018**

Kryetari i komisionit konstatoi se miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 korrik dhe 26 qershor 2018, komisioni do të bëjë në mbledhjen e radhës.

**3. Raportimi i ministrit të bujqësisë për dëmet e fundit në Kosovë nga reshjet e shiut.**

**Kryetari Daut Haradinaj**, tha se me kërkesën e komisionit, e kemi ftuar ministrin e MBPZHR-së, z. Nenad Rikalo dhe i uroi mirëseardhje. Arsyerja e kësaj ftese kanë qenë dëmet nga reshjet e fundit në Kosovë dhe shtoi se kemi marrë një raport nga ministria, të datës 28.6.2018 për

vlerësimin e dëmeve në terren, mirëpo nga terreni ka të dhëna tjera për dëme edhe më të mëdha dhe se ky raport nuk është i plotë. Pastaj, shtoi se ka probleme edhe të tjera në bujqësi dhe përmendi një kërkesë të Shoqatës së prodhuesve të mjedrave të Kosovës, për çmimin e mjedrave në Kosovë, i cili ka rënë dukshëm dhe po dëmtohen fermerët. Ai ftoi anëtarët e komisionit që pas fjalës së ministrit, të parashtrojnë pyetjet, njëherazi propozoi të fokusohen më shumë në temë dhe ia dha fjalën ministrit.

**Ministri Nenad Rikalo**, gjithashtu, falënderoi për bashkëpunim dhe duke iu drejtuar komisionit në lidhje me dëmet e shkaktuara nga reshjet e shiut dhe breshëri në bujqësi, i cili tha se inspektorët e ministrisë, menjëherë kanë dalë në terren dhe sipas raportit të përgatitur, vlera e dëmeve arrin në 1.2 milion euro dhe Komuna e Rahovecit është komuna që ka pësuar dëme më të mëdha. Mirëpo, kjo nuk paraqet të gjitha dëmet, pasi që nuk kemi arritur t'i përfshijmë të gjitha dhe se vlera e dëmeve mund të rritet, pasi që në ditët e ardhshme do të përgatitet raporti përfundimtar.

Në kuadër të kësaj, ai tha se probleme kryesore për ministrinë janë : mungesa e sistemit mbrojtës kundër breshrit, sigurimet bujqësore dhe fondi për kompensimin e dëmeve. Për sistemin e mbrojtjes kundër breshrit, theksoi se janë duke punuar një model me një organizatë zvicerane dhe atë ta vendosim edhe këtu, ndërsa shtoi se ky problem nuk është vetëm i MBPZHR-së, por edhe i institucioneve, tjera siç është KFOR-i, pasi që përfshin edhe çështjen e sigurisë. Ai shtoi se me Bankën Botërore, tashmë një vit, janë duke punuar në një projekt, për ta futur në bujqësi çështjen e sigurimit dhe kanë ardhur deri te faza kur po përgatitet baza ligjore për këtë dhe jemi shumë afër për të filluar një pilot-projekt për 7-9 kultura bujqësore. Kjo ide do të realizohet në atë mënyrë që në kuadër të sistemit të subvencioneve, të shtohet një masë e re dhe të gjithë fermerëve të interesuar, për të siguruar produktet e tyre bujqësore, mund të përfitojnë subvencione deri në 50% dhe 50% të participojnë vetë. Nuk ka fond specifik në buxhet për kompensimin e dëmeve në bujqësi, por kur të bëhet rishikimi i buxhetit dhe do të shohim a do të kemi sukses t'i kompensojmë 20 deri 25 për qind të dëmeve të shkaktuara. Ndërsa, për Fondin për kompensimin e dëmeve prej vitit 2009, kemi kërkuar nga Ministria e Financave për këtë, por nuk është përgjigjur pozitivisht, përfundoi ai.

Ai shprehu gatishmërinë që së bashku me zyrtarët e ministrisë, prezentë, të përgjigjet në pyetjet që parashtrohen.

**Liburn Aliu**, parashtrori pyetje në lidhje me sistemin mbrojtës kundër breshrit: A kanë filluar bisedimet me KFOR-in, ngase me informatën që e kam, ky sistem ka ekzistuar në vitet e 80-ta, ndërsa përse sot nuk e kemi, a është diskutuar kjo çështje deri më tani? A ju keni drejtuar Qeverisë për pagesat e dëmeve, pasi që ata nuk mund të përfitojnë këtë vit nëse kërkesa vonohet? Për grantet, a do të paguhet sivjet? Ndërsa, pyetje tjetër e drejtpërdrejt për ministrinë ishte, nëse mund të shpjegonte lidhjen në mes dy kompanive, "Koncept Pro" dhe "Extra Fruit", ngase nga informatat e ndryshme në media, jo që kishte ndonjë fakt, nëse mund ta shpjegonte lidhjen në mes këtyre dy kompanive se a ka ndonjë konflikt interesi.

**Salih Salihu**, përshëndeti ministrinë dhe shtoi se prezenca e tij në Kuvend është e domosdoshme, pasi që përkundër ftesave që i janë drejtuar ai ka munguar, duke ditur rëndësinë që ka bujqësia dhe prania e tij do ta bënte më të lehtë zgjidhjen e problemeve që dalin nga terreni. Parashtrori gjithashtu disa pyetje, pasi që është nevoja shumë e madhe për zgjedhjen e problemeve bujqësore në Kosovë, siç janë dëmet në bujqësi, mungesa e fondit për sigurimet bujqësore, mungesa e sistemit kundër breshrit, duke ndikuar kështu që fermerët tanë të jenë gjithmonë në rrezik. Ai përmendi edhe pakënaqësitë nga Unioni i Fermerëve, lidhur me shpërndarjen e granteve dhe potencoi që të bëhet kontrollimi i punës së tyre në lidhje me këto grante, sepse po iu ndërrohet destinacioni. Pse nuk bëhen kallëzime penale ndaj keqpërdoruesve të subvencioneve? Problem tjetër është edhe mungesa e inspektorëve bujqësorë, për tokat bujqësore, ku çdo vit uzurpohen rreth 500-1000 ha, gjithashtu ceku që ministria pa inspektorat për bujqësi nuk mund të jetë plotësisht funksionale.

Kryetari **Daut Haradinaj**, kërkoi nga deputetët që të koncentrohen kryesisht lidhur me problemin që është thirrur ministri, duke shtuar pyetjet se a do të mund të sigurohen mjetet për kompensimin e dëmeve në afatet optimale, duke përmendur konkretisht një zonë rreth 71 ha vreshta, që janë dëmtuar nga breshri dhe jo vetëm për këtë vit, por edhe vitin e ardhshëm do të ketë problem në dhënie rendimenti dhe ia dha fjalën **Ganimete Musliut**, e cila duke iu referuar asaj që deklaroi në fillim ministri rreth rishikimit të buxhetit, parashtrroi pyetjen: Çka nëse nuk do të ketë rishikim të buxhetit, duke marrë parasysh që Kuvendi shkon në pushim, nëse nuk do të ketë rishikim të buxhetit, fermeri a do të mbetet pa kompensim adekuat? Pse nuk është publikuar lista e grandeve për vitin 2017, por vetëm raportet e përzgjedhje ? Kërkoi mirëkuptim nga ministri për pyetjet që bëhen kurse nuk janë lidhur me rendin e ditës të mbledhjes së sotme, pasi që mungesa e tij në mbledhjet plenare ua pamundëson deputetëve drejtimin e pyetjeve të tjera.

**Andin Hoti** pasi që falënderoi të pranishmit dhe mediat, duke potencuar rëndësinë e kësaj mbledhjeje, tha se duke u bazuar në raportin e Komunës së Rahovecit, dëmet e llogaritura nga reshjet në këtë komunë, janë në sipërfaqe 1400 ha, në vlerë rreth 4.7 milionë euro me kultura bujqësore dhe infrastrukturë përcjellëse, andaj apeloj fillimisht për ndihmë urgjente, ngase Qeveria si gardian i fermerëve, duhet patjetër të reagojë, sepse fermerët, të vetmin burim të ardhurash i kanë këto të hyra. Duke iu referuar deklaratës së ministrit që pas rishikimit të buxhetit do të shikojnë se çfarë do të bëjnë, ai tha se deri më tani duhet të kishin një propozim konkret për kompensimin e dëmeve. Në lidhje me sigurimet bujqësore, pyeti: Çfarë ka ndërmarrë ministria për këto sigurime, sa do të jetë shuma që do të paguajnë fermerët e sa Qeveria ? Gjithashtu, kërkoi që të zhvendoset programi për ndihmë të fermerëve të vegjël nga komunat e veriut, në Prizren e Rahovec.

**Salih Zyba** theksoi se investimi në bujqësi duhet patjetër të ndodhë, ngase dëmet vazhdimisht po përsëriten çdo vit. Gjithashtu, pyeti: Sa kanë qenë të përfshirë ekspertët për vlerësimin e dëmeve në Rahovec ? Sa ka qenë në diskutim, në Qeveri, rishikimi i buxhetit, çfarë ka vepruar MB për sigurime në bujqësi, ngase investitorët e jashtëm hezitojnë për investime? A ka pasur diskutime me KFOR-in, rreth sistemit të mbrojtjes nga breshri.

**Enver Hoti** kërkoi urgjencë, sa i përket subvencioneve, përkatësisht ndihmave dhe të bëhen vlerësimet sa më shpejtë, sepse janë sezonale. Më tutje, pyeti për projektligjet: për pyje, për ushqimin, për bujqësi dhe zhvillim rural, për pijet alkoolike, për veterinarinë, që sipas agjendës legjislative është dashur t'i dërgohen Kuvendit, sidomos ajo e pyjeve dhe parqeve nacionale, që vazhdimisht degradohen dhe shkatërrohen egërsisht. Kryetari **Daut Haradinaj** duke u ndërlidhur me deputetin Enver Hoti, përmendi agjendën legjislative të MBPZHR-së, e cila ka pasur deri tash të dërgojë këto projektligje dhe shtoi se presim nga ministria të përcjellë sa më shpejt ato në Kuvend.

**Lutfi Zharku** përmendi mungesën e ministrit në interpelancën rreth veriut për 2.5 milionë në Kuvend dhe pyeti lidhur me udhëzimin administrativ 09/2018, cilat kanë qenë kriteret për përcaktimin e rajonit të veriut, si zonë më pak e zhvilluar? Ai vazhdoi edhe me pyetjen sa i përket trajtimit të dokumentacionit të aplikantëve në komunat e veriut, pa vulë apo logo të Kosovës. **Kryetari Daut Haradinaj** parashtrroi edhe një pyetje, në emër të **Danush Ademit** rreth qenve endacakë, duke kërkuar nga ministria përgjegjësinë në nivele komunale, për shkak se po paraqesin probleme serioze në zona të thella, e sidomos për komunitetet, kurse **Andin Hoti** iu drejtua të gjithëve që të fokusohen në temë dhe kishte pyetje shtesë: Si dhe kur do të kompensohen dëmet e shkaktuara ?

**Kryetari Daut Haradinaj** tha se deputetët ishin korrekt në pyetje, duke marrë parasysh që disa prej pyetjeve ishin jashtë temës, ai njoftoi ministrin se përgjigjet dhe pyetjet mund t'i jepen edhe me shkrim dhe ia dha fjalën për përgjigje.

**Ministri Nenad Rikalo** tha se janë pyetje të shumta, të parashtruara, por pasi janë të ndërlidhura, një përgjigje mund të përfshijë disa pyetje. Edhe një herë përsëriti se ministria nuk ka buxhet të veçantë për këto dëme, andaj duhet të shikohet mundësia, me aq mjete sa ka dhe duke kërkuar nga Qeveria buxhet shtesë, të kompensojë dëmet, por edhe ai u pajtua, jo me rishikim të buxhetit,

shumë shpejt pagesat do të fillojnë, ndoshta edhe një muaj e gjysmë, sepse ende nuk është kompletuar dokumentacioni për dëmet e shkaktuara. Vërtetimin e dëmit, ministria e bën duke dalë çdo ditë në terren dhe kështu shpresohet që shpejt do të kompletohet raporti. Metodën e vlerësimit të dëmeve do ta paraqesë Adem Arifaj. Në vazhdim, ministri ua dha fjalën bashkëpunëtorëve prezentë, nga disa drejtori, të cilët u përgjigjën në disa pyetje. **Bekim Hoxha**, drejtor i Departamentit për Vreshtari dhe Verëtari, sqaroi mënyrën e vlerësimit të dëmeve në vreshtari, ku ka pasur shumë dëme. Ai tha se në fillim themelohet komisioni i përbërë nga dy anëtarë të komunës dhe një anëtar i Departamentit të Vreshtarisë, dhe falë kadastrës së vreshtave, saktësisht është kufizuar zona e dëmtuar me sipërfaqe totale prej 2200 ha. Në kuadër të saj, dëmet janë përkufizuar sipas përqindjes, gjithashtu potencoi që dëme ka edhe në kulturat perimore. **Adem Arifaj**, kryetar i Komisionit për vlerësimin e dëmeve, shtoi se raportet vijnë nga drejtoritë komunale dhe pastaj ne dalim në terren për të verifikuar gjendjen. Ai shtoi se vitin e kaluar dëmet ishin mbi 15 milion euro, ndërsa në këtë vit, deri më tash, sipas vlerësimeve janë 1.2 milion euro dëme, ndoshta shumë komuna nuk kanë raportuar për shkak se vitin e kaluar nuk është bërë asnjë kompensim dhe ne si ministri nuk kemi vijë buxhetore për kompensimin e dëmeve, mirëpo deri në fund të vitit, përgatitet raporti përfundimtar. Kurse, sa i përket sistemit kundër breshrit, tha se nuk kemi marrë përgjigje negative nga KFOR-i, për shkak rrezikut në hapësirën ajrore. Gjithashtu, **Ekrem Gjokaj**, shtoi se në vitin 2012 është bërë një analizë për interesimin dhe gatishmërinë e kompanive të sigurimeve dhe bankave për sigurimet në bujqësi, por ka rezultuar se ato nuk kanë qenë të interesuara. Ai tha se me Bankën Botërore, tashmë një vit janë duke punuar në një projekt për ta futur në bujqësi çështjen e sigurimit dhe kanë ardhur deri te faza, kur po përgatitet baza ligjore për këtë dhe udhëzimi administrativ është në diskutim publik. Në lidhje me publikimin e përfituesve të grandeve, tha se do të bëhet në pjesën e dytë të korrikut, pasi që ka pasur shumë aplikantë. Nuk do të ketë vonesa për grande dhe subvencione. Për monitorimin e përfituesve, shtoi se ministria është duke realizuar një anketë me 2000 përfitues dhe 5000 jo përfitues të grandeve, e cila do të shërbejë për hartimin e programit të ri. Për humbjen e tokës bujqësore, tha se është kompetencë e komunave, ndërsa MBPZHR është përgjegjëse për ndërrimin e destinimit të tokës dhe këtë nuk e lejon, pa një arsyetim të fortë. Pas insistimit të **Ganimete Musliut**, rreth pyetjes për publikimin listës së grandeve, **Ekrem Gjokaj**, tha se i kemi edhe 7 lëndë në përfundim e sipër dhe se do të publikohen në fund të muajit korrik. **Ministri Rikalo** vazhdoi me disa përgjigje për mungesën e tij në Kuvend dhe potencoi se ai, sa herë që ftohet, iu përgjigjet ftesave, gjithashtu edhe komisioni mund të vizitojë ministrinë, sa herë që dëshiron. Sa i përket pyetjeve parlamentare, ai tha se deri më tani i ka pasur vetëm dy. Sa i përket interpelancës, ajo ka ndodhur me Kryeministrin, për shkaqe shëndetësore dhe jo politike. Momentalisht, janë disa mosmarrëveshje me partnerët e koalicionit në Qeveri, të cilat beson ai se do të tejkalohen. Sa i përket pyetjes, pse janë ndihmuar 4 komunat e veriut, ai tha se komisioni vlerësues ka pasur parasysh arsyet bazike dhe reale, të cilat kanë treguar nivelin e ulët të zhvillimit të fermerëve të kësaj ane. Me siguri, vitin e ardhshëm, i vjen radha Prizrenit, por ideja ka qenë të ngrihet niveli i zhvillimit të kësaj ane. Për pyetjen e Liburn Aliut, falënderoi për pyetje korrekte, të cilin e ftoi që të shikojë të gjitha dokumentacionet gjyqësore, ngase lënda është në gjykatë, por theksoi se këtu bëhet fjalë për diskreditimin e tij dhe personalitetit dhe nuk ekziston asnjë lidhje përfitimi në mes këtyre kompanive dhe tij. Ligjet që nuk janë dërguar në Kuvend, arsyeja e vetme është se Ministria kujdeset që mos të përsëriten gabimet e mëparshme rreth ligjit të pyjeve, kurse dy të tjera janë dërguar, por ende gjenden në Qeveri. Ligji për bujqësinë po përgatitet për vitin 2019, kurse për sigurime tha se do të përfshihen në tërësi, sipas sistemit 50 me 50. Për produktin shumë të rëndësishëm në Kosovë të mjedrës, ministria do të përkujdeset që me financim të përbashkët me USAID-in, të vijë në shprehje në kuptimin e plotë, si në prodhim, ashtu edhe në eksport.

**Daut Haradinaj** falënderoi ministrin dhe sa i përket praktikave, tha se mund të bazoheni edhe në vendet e rajonit, ku shtetet e ndryshme subvencionet i bëjnë në bazë të kilogramëve të eksportuar dhe potencoi se konsumi i mjedrës në vend është i ulët, ndërsa për eksport arrin vlerën deri mbi 15 milionë në vit. Pra, duke potencuar rëndësinë e këtij produkti, tha se kemi 2000 ha të mbjellë me mjedra. Pyetjet shitesë që u bënë nga deputetët ishin: **Lutfi Zharku**- A është trajtuar njëjtë

dokumentacioni i aplikantëve edhe gjatë Qeverisë së kaluar? **Enver Hoti**- Në katër komunat në pjesën veriore, komuniteti shqiptar që jeton në ato komuna kanë pasur vështirësi në sigurimin e dokumenteve komunale atje, si e keni parasysh zgjidhjen e këtyre ankesave? **Salih Zyba**-Raporti, që momentalisht e kemi, nuk i përfshin edhe dëmet e fundit që janë bërë kështu edhe pyetja është sa i përket dëmeve që janë në sezonin e korrjeve-shirjeve, dhe gjithashtu, sa ka ndikuar te qytetarët mosmarrëveshja ndërmjet koalicionit dhe cilët hapa po ndërmerren që mjedra të bëhet me interes strategjik për Kosovën? **Salih Salihu**-Në lidhje me Komisionin për vlerësimin e dëmeve që përbëhet nga 1 anëtar nga ministria dhe dy nga komuna, kurse **Andin Hoti** pyeti raporti i ministrisë ka mospërputhje ndërmjet numrit të hektarëve, a mund të shpjegohet kjo mospërputhje ? Kur do të dalë raporti përfundimtar për dëmet dhe kur do të kompensohen? **Liburn Aliu** shprehu interesim rreth vendimit të gjykatës, lidhur me një superkontroll të rastit me kompaninë“Extra Fruit” dhe lidhur me fondin për veriun, që përfshin 4 komunat veriore, ka dyshime se është ndarë në bazë etnike. Ndërsa, për sistemin e mbrojtjes kundër breshrit, pyeti: Nëse vendet e rajonit janë të pajisura me këtë sistem, duke ditur se edhe atje aviacioni është i pranishëm, pse vetëm te ne nuk ekziston ky sistem, a ka ndonjë arsye? Sepse, breshëri po bëhet problem serioz për bujqësinë.

**Ministri Nenad Rikalo**, potencoi se raporti përfundimtar për dëmet do të publikohet në mes të muajit gusht dhe se do të kompensohen të gjitha dëmet. Rahoveci është komuna me më së shumti dëme. Për programin për zonat e pazhvilluara, kriter ka qenë niveli i zhvillimit dhe vitin e ardhshëm do të bëhet analizë dhe do të ndihmohen zonat më të pazhvilluara. Për sistemin kundër-breshër, tha se është një temë komplekse, të cilën nuk mundet vetëm MBPZHR ta zgjidhë, duhet edhe bashkëpunim me institucionet tjera. Lidhur me këtë, janë duke e shqyrtuar një model zviceran me rrjeta mbrojtëse ndaj breshrit. Në lidhje me dokumentacionin e aplikantëve, tha se ka pasur 120 aplikacione, ku ka pasur edhe banorë shqiptarë dhe të gjitha janë trajtuar njësoj dhe nuk ka pasur ndikim politik ky projekt.

Kryetari **Daut Haradinaj** në fund të mbledhjes, falënderoi ministrin për gatishmërinë dhe prezencën në mbledhjen e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

Kryetari i komisionit,  
**Daut Haradinaj**